

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Dr.sc Driton Muharremi e Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, procesmbajtëse, në çështjen penale të dënuarit M.R., nga Gjilani, për shkak të veprave penale Vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e të akuzuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda, PK.nr.175/2018, P.nr.517/18 datë 24.12.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 01.02.2019 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të dënuarit M.R., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda PK.nr.175/2018, P.nr.517/18 datë 24.12.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PK.nr.175/2018, P.nr.517/18 datë 24.12.2018, konform dispozitave së nenit 420 par.1 pika 1.1 dhe par. 2 të KPRK lidhur me nenin 80 par.1 dhe 2 pika 2.2 të KPRK i ka ndryshuar aktgjykimet e plotfuqishme:

- aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.175/2018, me të cilin i akuzuari M.R. për veprën penale v Vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 12.07.2018 e deri në datën 29.10.2018.

- aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan P.nr.517/2018 datë 27.06.2018 me të cilin i akuzuari për veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj dhe më dënim me gjobë në shumë prej 400 euro. Në dënimin e shqiptuar me burgim të akuzuarit i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 06.06.2018 deri me datën 26.06.2018.

Gjykata e shkallës së parë duke ia marrë si të vërtetuara këto dënime konform dispozitës së nenit 80, 82 dhe 83 të KPRK-së ka gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve e 7 (shtatë) muaj dhe me dënim me gjobë në shumë prej 400 euro, duke ia llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim si në aktgjykimet e lartcekura.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur i akuzuari M.R., për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal duke propozuar që Gjykata Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë dhe ndaj tij te shqiptoj një dënim të unifikuar me të butë ose rastin ta kthejë në rivendosje.

-Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.38/19 datë 17.01.2019 ka propozuar që ankesa e të dënuarit të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa nuk është e bazuar.

Në ankesë i dënuari thekson se dënimi i shqiptuar sipas kërkesës për bashkim të dënimeve nuk është i drejtë, pasi thekson se gjykata thajse vetëm formalisht e ka bërë bashkimin e dënimeve sepse dënimi unik i shqiptuar dallon vetëm një muaj nga dënimet paraprake, dhe se i dënuari konsideron se ka përfutur pak nga ky bashkim i dënimeve.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se pretendimet për një dënim të unifikuar me të butë nuk janë të bazuara. Sepse gjykata e shkallës së parë i ka pasur parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat të përcaktuara me nenin 73 të KPRK të cilat janë paraqitur gjatë matjes së llojit dhe lartësisë së dënimeve të shqiptuara me aktgjykimet e plotfuqishme. Ne praninë e këtyre rrethanave si pranimi i fajësisë në mënyrë vullnetare nga ana e të dënuarit, ndërsa si rrethanë rënduese mori faktin se këto vepra penale janë dukuri shumë e shpeshtë kohëve të fundit, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i unifikuar sipas kërkesë për bashkim të dënimeve ndaj të dënuarit është i drejtë dhe është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale, shkallës së përgjegjësisë penale dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.22/19, me 01.02.2019

Procesmbajtësja,
Syzana Goxhuli

Kryetarja e kolegjit- gjyqtarja
1. Mejreme Memaj

Anëtarët e kolegjit:

2 . Dr.sc. Driton Muharremi

3.Afrim Shala